



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 qershor 2012
Nr. ref.:AGJ262/12

AKTGJYKIM

në

Rastin Nr. K106/12

Parashtruesi

Bajrush Gashi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pzd. nr.
67/2011, të 12 dhjetorit 2011.**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Bajrush Gashi, me vendbanim në fshatin Hoçë e Vogël, Rahovec.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 67/2011, të 12 dhjetorit 2011, i cili iu dorëzua në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) më 27 janar 2012, me të cilën kërkonte vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 67/2011.
4. Parashtruesi pohon që vendimi i kontestuar ia ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe rregulli 56 (1) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 27 janar 2012.
7. Më 30 janar 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. 06/12, e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. 06/12, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Enver Hasani dhe Kadri Kryeziu.
8. Më 6 mars 2012, Gjykata ia komunikoi kërkesën Gjykatës Supreme dhe kërkoi nga ajo që t'i dorëzonte komentet e veta në lidhje me këtë kërkesë.
9. Më 21 mars 2012, Gjykata kërkoi nga Gjykata Supreme që ta dorëzonte dosjen e rastit Pzd. nr. 67/2011, të 12 dhjetorit 2011, dhe komentet shtesë.
10. Gjykata Supreme u përgjigj më 22 mars 2012, duke i dërguar komentet e veta në lidhje me kërkesën, por nuk e dorëzoi dosjen e lëndës.
11. Në përgjigjen e vet të 22 marsit 2012, Gjykata Supreme e informoi Gjykatën se:

“ ...

Nga shkresat e lëndës rezulton se i dënuari Bajrush Gashi pretendon se atij i është cenuar e drejta për një gjykim të paanshëm e të drejtë, ngase në panelin gjyqësor pranë Gjykatës Supreme, me rastin e shqyrtimit të kërkesës së tij për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, paska marr pjesë një anëtar paneli, i cili në çështjen e njëjtë ndaj tij ka marrë pjesë edhe në shkallë të parë.

Është e vërtetë se në procedurën e shqyrtimit të kërkesës për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit pranë kësaj Gjykate një anëtar i panelit ka qenë edhe

kryetare e panelit në gjykatën e shkallës së parë, mirëpo kjo rrethanë nuk paraqet asnjë pengesë ligjore për këto arsye:

Në procedurën e zbutjes së jashtëzakonshme të dënimit mund të merr pjesë gjyqtari që ka qenë kryetar i trupit gjykues apo anëtar i trupit gjykues edhe në procedurën e shkallës së parë. Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit i paraqitet gjykatës së shkallës së parë-kryetarit të trupit gjykues që ka kryesuar panelin në shkallë të parë apo që ka vepruar si gjyqtar i vetëm (neni 450 i KPPK), i cili ndërmerr disa veprime procedurale e pastaj lëndën, me propozim të e arsyetuar, ia dërgon Gjykatës Supreme, e cila vendos lidhur me kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore që në panele të marrë pjesë ndonjë anëtar apo të gjithë anëtarët që kanë marr pjesë edhe më parë në panele gjyqësore për çështjen e njëjtë.

Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme mund të paraqitet disa herë (nga i njëjti i dënuar), sa herë që konsideron se është paraqitur ndonjë rrethanë e re që ai e vlerëson me ndikim për zbutje të dënimit. Mirëpo, po të përjashtoheshin anëtarët që kanë qenë të përfshirë në ndonjë fazë të procedurës, atëherë Gjykata Supreme s'do të kishte gjyqtar për të vendosur lidhur me kërkesën, kështu që kërkesat do ngelnin të pashqyrtuara.

Te ky mjet i jashtëzakonshëm juridik bëhet fjalë për rrethana të reja, për të cilat gjyqtari, edhe po të ketë qenë pjesë e panelit të mëhershëm, s'ka mundur të krijojë paragjykime, (sepse kjo rrethanë shqyrtohet për herë të parë).

Për të qenë më i qartë, unë po ju dërgoj një pjesë të komentit që bën fjalë për këtë situatë, ku thuhet qartë se gjyqtari që ka marrë pjesë në marrjen e aktgjykimit, mund të marr pjesë edhe me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit.

Në zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, gjyqtarët që kanë marrë pjesë në marrjen e vendimit mund të marrin pjesë edhe në procedurën e gjykatës së shkallës së parë (neni 414 – refuzimi i kërkesës, hetimi dhe propozimi) dhe në vendimin përfundimtar në gjykatën kompetente. Situata është e ngjashme me atë të përsëritjes së procedurës penale: bëhet fjalë për material të ri apo rrethana të reja për të cilat gjyqtari nuk mund të ketë paragjykime, prandaj edhe zgjidhja duhet të jetë pa paragjykime.

...”

12. Më 30 mars 2012, Gjykata e njoftoi parashtruesin se Gjykata Supreme i kishte dërguar komentet e veta dhe kërkoi komentet e tij, nëse ka, lidhur me përgjigjen e Gjykatës Supreme. Gjykata nuk ka marrë asnjë përgjigje deri më tani.
13. Më 9 maj 2012 Gjykata mbajti këshillime dhe votoi për rastin.

Përmbledhje e fakteve

14. Më 19 maj 2009, Gjykata e Qarkut në Prizren, e shpalli parashtruesin fajtor për kryerje të veprës penale nga neni 138.6 lidhur me 138.1 dhe nenin 328.2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK) dhe e dënoi me 4 vjet e 4 muaj burg (Aktgjykimi P. nr. 26/09). Parashtruesi u ankua kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme për shkak të “shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim me propozimin që aktgjykimi të ndryshohet në mënyrë që i

pandehuri të lirohet nga aktakuza apo të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim". Prokurori publik u ankua kundër këtij aktgjykimi lidhur me pjesën që kishte të bënte me të bashkëpandehurin G.M.

15. Më 8 dhjetor 2010, Gjykata Supreme e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe ankesën e prokurorit publik dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut (Aktgjykimi Ap. nr. 259/2009). Gjykata Supreme konstatoi që aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut është i bazuar në gjendjen faktike dhe gjykata e shkallës së parë e vërtetoi gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë, dhe gjykata e shkallës së parë gjithashtu ka dhënë arsyet ligjore për faktet vendimtare. Përveç kësaj, Gjykata Supreme konkludoi që aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut nuk përmbante shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, siç pretendohet nga parashtruesi.
16. Më 12 dhjetor 2011, Gjykata Supreme e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit (Aktgjykimi Pzd. nr. 67/2011). Gjykata Supreme, duke marrë parasysh mendimin e Gjykatës së Qarkut, të prokurorit publik të qarkut dhe të prokurorit të shtetit, që kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ishte e pabazuar, vendosi që arsyet e parashtruesit për kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit nuk ishin të një natyre të tillë që do ta justifikonin zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të parashtruesit.

Pretendimet e parashtruesit

17. Parashtruesi pohon që gjyqtari që ishte kryetar i trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe kishte vendosur në rastin e tij, mori pjesë edhe në vendimin e Gjykatës Supreme lidhur me kërkesën e tij për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit (gjyqtari në fjalë).
18. Përveç kësaj, parashtruesi pohon që gjyqtari në fjalë është dashur ta njoftonte Gjykatën Supreme se i njëjti ishte kryetar i trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut në Prizren dhe se gjyqtari në fjalë është dashur të përjashtohet nga pjesëmarrja në kolegjin e Gjykatës Supreme.
19. Prandaj, parashtruesi konsideron që gjyqtari i Gjykatës Supreme ka shkelur nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

Dispozitat e ligjit të zbatueshëm lidhur me procedurat për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës (Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26), e 6 korrikut 2003

20. Procedura për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit rregullohet me Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPPK).

Përjashtimi i gjyqtarit

21. Neni 40

“... ”

(1) Gjyqtari ose gjyqtari laik përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në rastin kur:

5) Në të njëjtën çështje ka marrë pjesë në marrjen e vendimit në gjykatën më të ulët ose nëse në gjykatën e njëjtë ka marrë pjesë në marrjen e vendimit i cili kundërshtohet me ankesë.

...”

22. Neni 41

“...

(1) Gjyqtari ose gjyqtari laik posa të mësojë se ekziston ndonjë arsye për përjashtim nga neni 40 paragrafi 1 ose 2 i këtij Kodi ndërpret çdo aktivitet lidhur me çështjen dhe për këtë e njofton kryetarin e gjykatës, i cili sipas rregullave të brendshme të gjykatës cakton zëvendësimin e tij. Në rastin e përjashtimit të kryetarit të gjykatës, ai kërkon drejtpërdrejt nga kryetari i gjykatës më të lartë të caktojë zëvendësimin.

(2) Në qoftë se gjyqtari ose gjyqtari laik mendon se ekzistojnë rrethana të cilat arsyetojnë përjashtimin e tij (neni 40 paragrafi 3 i këtij Kodi) për këtë e njofton kryetarin e gjykatës. Derisa të merret vendim për përjashtim, gjyqtari ose gjyqtari laik mund të ndërmerret vetëm ato veprime të cilat janë domosdo të nevojshme për të penguar shtyrjen ose vonesën e palejueshme të çështjes.

...”

Zbutja e jashtëzakonshme e dënimit

23. Neni 448

“Zbutja e jashtëzakonshme e dënimit lejohet kur pas formës së prerë të aktgjykimit paraqiten rrethana të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimit ose, megjithëse kanë ekzistuar në atë kohë, gjykata nuk ka qenë në dijeni për to, kurse ato dukshëm do të ndikonin në dënim më të ulët.”

24. Neni 449

“...

(1) Kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit mund të paraqesë prokurori publik kur procedura është zbatuar me kërkesë të tij, i dënuari dhe mbrojtësi i tij.

(2) Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit nuk e pezullon ekzekutimin e dënimit.

...”

25. Neni 450

“...

(1) Për kërkesën mbi zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit vendos Gjykata Supreme e Kosovës.

(2) Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit i paraqitet gjykatës e cila ka marrë aktgjykimin në shkallë të parë.

(3) Kryetari i trupit gjykues i gjykatës së shkallës së parë e hudh kërkesën e paraqitur nga personi i paautorizuar për paraqitjen e saj.

(4) Gjykata e shkallës së parë vërteton se a ekzistojnë shkaqe për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit dhe pas dëgjimit të prokurorit publik, nëse procedura është zbatuar sipas kërkesës së tij, personit të dënuar ose mbrojtësit të tij e pastaj shkresat me propozimin e arsytuar ia dërgon Gjykatës Supreme.

(5) Kur vepra penale e cila ndiqet sipas kërkesës së prokurorit publik, Gjykata Supreme, para marrjes së vendimit mbi zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit ia dërgon shkresat Prokurorit Publik të Kosovës i cili mund t'i paraqesë propozim me shkrim gjykatës. Mbrojtësi ka qasje në këto shkresa.

(6) Gjykata Supreme e Kosovës refuzon kërkesën kur çmon se nuk ka baza ligjore për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit. Kur e aprovon kërkesën, gjykata me aktvendim e ndryshon aktgjykimin e formës së prerë lidhur me vendimin mbi dënimin.

...”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

26. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe në Rregullore të punës.
27. Gjykata duhet të përcaktojë së pari nëse parashtruesi është palë e autorizuar sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë që “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.” Në këtë drejtim, kërkesa është dorëzuar në Gjykatë nga një individ. Prandaj, parashtruesi është palë e autorizuar, ka të drejtë ta ngrejë këtë rast në Gjykatë sipas nenit 113.7 të Kushtetutës.
28. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës në pajtim me nenin 49 të Ligjit duhet ta dorëzojë kërkesën brenda 4 muajve pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më 12 dhjetor 2011, Gjykata Supreme nxori Vendimin Pzd. nr. 67/2011, kurse parashtruesi e mori atë vendim në një datë të pacaktuar. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 27 janar 2012. Prandaj, parashtruesi e ka përmbushur afatin kohor për parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.
29. Përveç kësaj, në bazë të nenit 450.1 të KPPPK-së, Gjykata Supreme konsiderohet “si gjykatë e shkallës së fundit për të gjykuar për çështje që lidhen me zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit”. Si rrjedhojë, Gjykata po ashtu përcakton se parashtruesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të Kosovës.
30. Përfundimisht, neni 48 i Ligjit përcakton që: “Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.” Në këtë drejtim, Gjykata vëren që parashtruesi e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 67/2011, i cili, gjoja, ia ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës gjithashtu e ka përmbushur këtë kriter.

31. Pasi parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, pasi i ka përmbushur afatet kohore për të parashtruar kërkesë në Gjykatë, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, dhe pasi e ka qartësuar saktësisht shkeljen e supozuar të të drejtave dhe lirive, duke përfshirë vendimin që e konteston, Gjykata konkludon që parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri.

Vlerësimi kushtetues i kërkesës

32. Pasi parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret procedurale për pranueshmëri, Gjykata duhet t'i shqyrtojë meritat e ankesës së parashtruesit.
33. Gjykata vëren që parashtruesi e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 67/2011, të 12 dhjetorit 2011, me të cilin iu refuzua si e pabazuar kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit.
34. Në fakt, Gjykata Supreme, duke marrë parasysh mendimin e Gjykatës së Qarkut, të prokurorit publik të qarkut dhe të prokurorit të shtetit, vendosi që arsyet e parashtruesit për kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit nuk ishin të një natyre të tillë që do ta justifikonin zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të parashtruesit dhe e refuzuan kërkesën si të pabazuar.
35. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese vëren që gjyqtari që ishte kryetar i trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut në Prizren kur parashtruesi u dënua me burg po ashtu ka marrë pjesë në procesin e marrjes së vendimit në Gjykatën Supreme në lidhje me kërkesën e parashtruesit për zbutjen e dënimit të shqiptuar nga Gjykata e Qarkut në Prizren..
36. Gjykata rikujton se procedura që ka të bëjë me zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit nuk parashikon procedurë publike në të cilën parashtruesi mund të marrë pjesë. Kjo procedurë bazohet vetëm në parashtrësia me shkrim. Prandaj, parashtruesi nuk ka mundur të dinte që gjyqtari kryesues i trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut në Prizren gjithashtu po merrte pjesë në vendimin e Gjykatës Supreme lidhur me kërkesën e tij për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit. Ai e kuptoi këtë vetëm pasi mori vendimin me të cilin i refuzohej kërkesa.
37. Gjykata vëren që neni 40.1 (5) i KPPPK-së përcakton *“Gjyqtari ose gjyqtari laik përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në rastin kur: Në të njëjtën çështje ka marrë pjesë në marrjen e vendimit në gjykatën më të ulët ose nëse në gjykatën e njëjtë ka marrë pjesë në marrjen e vendimit i cili kundërshtohet me ankesë”*.
38. Përveç kësaj, në përputhje me nenin 41 të KPPPK-së, në qoftë se *“gjyqtari ose gjyqtari laik mëson se ekziston ndonjë arsye për përjashtim nga neni 40 paragrafi 1 ose 2 i këtij Kodi ndërpret çdo aktivitet lidhur me çështjen dhe për këtë e njofton kryetarin e gjykatës, i cili sipas rregullave të brendshme të gjykatës cakton zëvendësimin e tij.”* E njëjta vlen *“Në qoftë se gjyqtari ose gjyqtari laik mendon se ekzistojnë rrethana të cilat arsyetojnë përjashtimin e tij (neni 40 paragrafi 3 i këtij Kodi) për këtë e njofton kryetarin e gjykatës”*.
39. Përveç kësaj, Gjykata Supreme konfirmoi në përgjigjen e vet se në procedurën për shqyrtimin e kërkesës për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit një anëtar i trupit gjykues ishte edhe kryetar i trupit gjykues në gjykatën e shkallës së parë ku ishte shqiptuar i njëjti dënim. Gjykata Supreme më tej theksoi se kjo nuk paraqiste kurrfarë pengese për shkak se kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit së pari i ishte paraqitur gjykatës së shkallës së parë, kryetarit të trupit gjykues që e kishte kryesuar trupin gjykues në shkallën e parë ose kishte vepruar si gjyqtar i vetëm që kishte marrë

masa procedurale dhe më pas, me propozim të arsyetuar, i ishte paraqitur Gjykatës Supreme. Përveç kësaj, Gjykata Supreme tha se sikur të përjashtoheshin të gjithë anëtarët që kanë qenë të përfshirë në ndonjë fazë të procedurës, atëherë Gjykata Supreme nuk do të kishte gjyqtarë për të vendosur për kërkesën.

40. Megjithatë, parashtruesi pohon që nuk ka pasur “gjykim të drejtë” nga një “tribunal i paanshëm i themeluar me ligj” në kuptim të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili në pjesën përkatëse përcakton:

“2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm ... për cilëndo akuzë penale ... nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, i cili në pjesën përkatëse përcakton:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht ... nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj... e cila do të vendosë në lidhje me çdo akuzë penale në ngarkim të tij...”,

41. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjyqtari në fjalë është dashur ta kishte njoftuar Gjykatën Supreme se ajo ka qenë kryetare e trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut në Prizren dhe, për këtë arsye, duhej të përjashtohet nga pjesëmarrja në kolegjin e Gjykatës Supreme. Gjyqtari në fjalë ka mundur të përjashtohet ex officio nga ana e Gjykatës Supreme, pasi që fakti se ka qenë gjyqtar kryesues në Gjykatën e Qarkut në Prizren ishte informacion zyrtar që përmendej në objektin e çështjes së lëndës.
42. Parashtruesi më tej ankohet se pasi nuk ishte në dijeni që gjyqtari në fjalë kishte marrë pjesë në procedurën për shqyrtimin e kërkesës të tij, pasi kjo procedurë ishte mbajtur në mungesë të tij, ai nuk e dinte kush kishte marrë pjesë në këtë procedurë.
43. Gjykata tani duhet të shqyrtojë nëse një gjyqtar i përfshirë si kryetar i trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut në dënimin e një personi, do të mund të merrte pjesë më vonë, si gjyqtar i Gjykatës Supreme, në kolegjin që merret me kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit për të njëjtin person të dënuar.
44. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron që paanësia e një tribunali sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së duhet të përcaktohet sipas një testi subjektiv, pra në bazë të bindjes dhe sjelljes personale të një gjyqtari në një rast të caktuar, dhe gjithashtu sipas testit objektiv, pra konstatimit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për ta përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë drejtim (shih ndër autoritete të tjera, Hauschildt kundër Danimarkës, aktgjykim i 24 majit 1989, Seria A nr. 154, f. 21, para. 46, dhe Thomann kundër Zvicrës, aktgjykim i 10 qershorit 1996, Raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve 1996-III, f. 815, para. 30).
45. Sa i përket testit subjektiv, për shkak të natyrës së shkruar të procedurës, as parashtruesi as avokati nuk kanë mundur të jenë në dijeni, derisa nuk e kanë marrë vendimin e Gjykatës Supreme, se e njëjta gjyqtare që ishte kryetare e trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut në Prizren mori pjesë edhe në trupin gjykues të Gjykatës Supreme që vendosi për kërkesën e tij për zbutjen e dënimit. Prandaj, nuk mund të konkludohet që parashtruesi ka hequr dorë nga e drejta për përcaktimin e të drejtave të tij nga një “tribunal i paanshëm” (shih, *mutatis mutandis*, Oberschlick kundër Austrisë, nr. 11662/85, aktgjykim i 23 majit 1991).

46. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme është dashur që gjyqtari në fjalë në pajtim me nenin 41 të KPPPK-së ta tërheq ose është dashur të tërhiqet *ex officio* nga procedura për shqyrtimin e dënimit.
47. Sa i përket testit objektiv, Gjykata vëren që duhet të përcaktohet nëse, ka fakte të vërtetueshme që mund të ngrenë dyshime se a mundet një gjyqtar i caktuar të jetë i drejtë dhe i paanshëm në një rast të caktuar. Në këtë drejtim, mënyra se si duket diçka është me rëndësi. Ajo që është në rrezik është besimi që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet ta frymëzojnë në publik, dhe, mbi të gjitha, në të akuzuarin, sa u përket procedurave penale. Si rrjedhojë, cilido gjyqtar për të cilin ka arsye legjitime për të pasur frikë për mungesë të paanshmërisë duhet të tërhiqet (shih ndër autoritete të tjera, Hauschildt kundër Danimarkës, aktgjykim i 24 majit 1989, Seria A nr. 154, f. 21, para. 46).
48. Gjykata vëren që në rastin në fjalë frika për mungesë të paanshmërisë rrjedh nga fakti se gjyqtari në fjalë si kryetar i trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut në Prizren, e dënoi parashtruesin me burg. I njëjti gjyqtar gjithashtu ishte anëtar i kolegjit të Gjykatës Supreme kur ky kolegji vendosi se kërkesa e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ishte e papabuar.
49. Gjykata vëren që nenet 40 dhe 41 të KPPPK-së manifestojnë brengën e ligjvënësit për t'i hequr të gjitha dyshimet e arsyeshme sa i përket paanshmërisë së Gjykatës. Si rrjedhojë, dështimi i Gjykatës Supreme për të vepruar në përputhje me këtë rregull do të thotë që kërkesa e parashtruesit për zbutje të dënimit u dëgjua nga një tribunal, paanshmëria e të cilit u njoh nga KPPPK-ja si e hapur për dyshime (shih, *mutatis mutandis*, Oberschlick kundër Austrisë, nr. 11662/85, aktgjykim i 23 majit 1991).
50. Prandaj, Gjykata është e mendimit se në rrethanat e këtij rasti, paanshmëria e Gjykatës Supreme mund të duket e hapur për dyshime dhe se frikët e parashtruesit në këtë drejtim mund të konsiderohen subjektivisht dhe objektivisht të arsyetueshme.
51. Gjykata Supreme argumentoi se sikur të përjashtoheshin të gjithë anëtarët që kanë qenë të përfshirë në ndonjë fazë të procedurës, atëherë Gjykata Supreme nuk do të kishte gjyqtarë për të vendosur për kërkesën. Gjykata konsideron që çështja nëse ka apo nuk ka numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve për të vendosur për kërkesat për zbutje të dënimit është çështje krejtësisht nën juridiksion, dhe për diskutim, po qe nevoja, ndërmjet gjyqësorit dhe Qeverisë. Përgjegjësia primare për administrimin e mirëfilltë të drejtësisë i takon Qeverisë dhe çështjet organizative nuk mund të përdoren si arsye për mosrespektim të Kushtetutës (shih Rastin Nr. KO 4/11, Gjykata Supreme e Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, Nr. 03/L-139, aktgjykim i 1 marsit 2012)
52. Në këto rrethana, Gjykata konstaton që është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nga një tribunal i pavarur, siç garantohet me nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56 (1) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 9 maj 2012, njëzëri vendosi


- I. TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;
- II. TA SHPALLË të pavlefshëm Vendimin e Gjykatës Supreme Pzd. nr. 67/2011 të 12 dhjetorit 2011, i cili shkel nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
- III. TA KTHEJË Vendimin Pzd. nr. 67/2011 të Gjykatës Supreme të 12 dhjetorit 2011 në Gjykatën Supreme për rishqyrtim në pajtueshmëri me aktgjykimin e kësaj Gjykate në bazë të rregullit 74 (1) të Rregullores së Punës;
- IV. Në bazë të rregullit 63 (5) të Rregullores së Punës, Gjykata Supreme duhet t'i dorëzojë informacione Gjykatës Kushtetuese për masat e ndërmarra në zbatimin e këtij aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese;
- V. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- VI. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani